

VENDIM
Nr.79, datë 24.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SELCA ENERGY” SHPK, PËR LËNIE PENG SI KOLATERAL TË
HEC/SELCA

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 20, pika 1 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.89, datë 13.12.2006, nenit 8, si dhe pikës 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P për prodhimin e energjisë elektrike, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Selca Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për lënien peng të asetit të hec-“Selca” si kolateral pranë Bankës Credins,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Selca Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 89, datë 13.12.2006, si më poshtë:

Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2

Është paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.

Neni 7, pika 1.3, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”

Është paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.

Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Selca Energy” sh.p.k, për lënie peng si kolateral të Hec/Selca pranë Bankës Credins.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani